

BROSHURË INFORMUESE DHE UDHËZUESE

“

“Për parandalimin e sjelljeve të kundraligjshme tek fëmijët dhe njohjen e tyre me drejtësinë penale”

”





QPKMR
*Qendra e Parandalimit Te Krimeve
Te Te Mituarve dhe Te Bujave*



Ministry of Foreign Affairs of the
Netherlands

Hartimi i këtij libërthi realizohet në kuadër të nismës “Drejt një mjedisi të sigurt, stimulues dhe rehabilitues në burgje për fëmijët dhe të miturit në konflikt me ligjin në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni”, zbatuar me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës

Të dhënat e shprehura në këtë manual udhëzues janë përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës apo institucioneve përgjegjëse të përfshira në konsultime në këtë material.

Përgatiti:

1. Prof. Dr. Vasilika Hysi, Eksperte Ligjore e Nivelit të Lartë

Redaktor letrar:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektesh, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,

Tirana-Albania
Kutia Postare nr. 1752;

Tel: 042233671
Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al
Website: www.ahc.org.al

Përmbajtja e punimit

Fjalorth.....	5
1.Hyrje.....	7
2.Të drejtat dhe përgjegjësitë e të miturit para ligjit.....	8
2.1.Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijës përcaktohen në ligje jopenale dhe penale.....	8
2.2.Ku mund të gjeni informacione për sjelljet e ndaluara dhe të dënueshme nga ligji të tjera jo penale?.....	9
3.Në cilën moshë ligji ngarkon me përgjegjësi penale të miturin?.....	12
4.Zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.....	13
4.1.Drejtësia miqësore për çdo fëmijë.....	13
4.2.Ç'ndodh pas kryerjes së një vepre penale?.....	14
5.Çfarë ndodh nëse një i mitur arrestohet?.....	14
6.Zbatimi i masave alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimi.....	15
7.Cilat janë masat që mund të jepen ndaj të miturit kur vendoset shmangia?.....	16
Në rast se detyrimet e vendosura përmbushen, procedimi penal ndaj të miturit pushon.....	16
7.1.Drejtësia restauruese.....	17

7.2. Ndërmjetësimi.....	17
8. Masat detyruese ndaj të miturit në rast të shmangies.....	18
9. Çfarë ndodh nëse masa e shmangies ose detyrimet e caktuara nuk përmbushen nga i mituri?.....	19
9.1. Vendosja nën kujdes e të miturit.....	19
9.2. Hetimi, të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin.....	20
10. Gjykimi.....	21
11. Dënimi i të miturit.....	21
12. Çfarë ndodh para mbarimit të dënimit dhe daljes nga institucioni?.....	22
13. Çfarë ndodh pas lirimit me kusht ose përfundimit të dënimit?.....	23
14. Institucionet përgjegjëse që trajtojnë të miturin në konflikt me ligjin.....	23
Provo veten.....	24

Fjalorth

Drejtësi penale për të mitur

Procedurat që lidhen me veprat penale dhe që përfshin hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit dhe çdo masë tjetër që përfshin të mitur në konflikt me ligjin, ose viktimë ose dëshmitar të një vepre penale

Drejtësi restauruese

Çdo proces në të cilit i mituri në konflikt me ligjin, viktimë (personi i dëmtuar) dhe ose individë të tjerë ose pjesëmarrës të komunitetit që janë ndikuar nga vepra penale e kryer marrin pjesë bashkarisht për të zgjidhur çështjet që kanë lindur nga vepra penale e kryer dhe të korrigjohen pasojat e ardhura prej saj, si rregull me ndihmën e një pale të tretë, të drejtë dhe të paanshme.

Mosha minimale për përgjegjësi penale

Mosha e caktuar nga ligji penal me arritjen e së cilës i mituri ka përgjegjësi penale. Për kundërvajtjet parashikohet 16 vjeç dhe për krimet parashikohet 14 vjeç.

Ndërmjetësim

Procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësore dhe me dialog mes të miturit që ka kryer një veprë penale dhe viktimës, e kryer nga një ndërmjetës, me qëllim zgjidhjen e pasojave të veprës penale dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis tyre

Interesi më i lartë i fëmijës

E drejta e fëmijës për të pasur zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, shoqëror dhe e drejta për të gëzuar një jetë familjare dhe shoqërore të përshtatshme për fëmijën

Fëmijë

Çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi i mitur përdoret për fëmijët nën moshën 18 vjeç, kryesisht në legjislacionin penal.

I mitur në konflikt me ligjin

I mituri që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe ka kryer një vepër penale që parashikohet në Kodin Penal.




Përgjegjësi penale

Përgjegjësia që ka një person i cili ka arritur moshën e caktuar nga ligji në çastin kur ka kryer një vepër penale.

Rishoqërizim ose rehabilitimi i të miturit

Inkurajimi dhe zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë, për të respektuar të drejtat e të tjerëve, për të nxitur dhe mundësuar zhvillimin e shëndetshëm fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të të miturit dhe përgatitja që fëmija të rikthehet në shoqëri.





1. Hyrje

Drejtësia penale miqësore për të miturin për herë të parë u rregullua me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur (Kodi). Kodi përcakton rregullat sesi duhet të funksionojë drejtësia kur një i mitur përfshihet në kryerjen e veprave penale ose është viktimë ose dëshmitar i saj. Rregullat synojnë ta ndihmojnë të miturin për t'u kthyer në shoqëri dhe të parandalojnë përsëritjen e veprave penale prej tij.

Rregullat janë shumë miqësore për të miturit. Ato mbajnë parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe zbatohen për çdo fëmijë pa diskriminim, me qëllim që zhvillimi harmonik i të miturit të vijoje pavarësisht gabimit që mund të këtë bërë. Edhe kur një i mitur gabon, edukimi dhe rikthimi i tij në shoqëri kërkohet të arrihet me masa më të buta sesa vendosja në një institucion.

I mituri në konflikt me ligjin ka të drejta dhe detyrime në çdo fazë që i mituri është në kontakt me drejtësinë për të miturit. Ato nuk mund të trajtohen në një botim informues si ky dhe ku gjuha e ligjit thjeshtësohet për të qenë e kuptueshme për fëmijët e moshës 14–18 vjeç. Ky botim nuk mund të zëvendësojë Kodin dhe ligjet e tjera që rregullojnë drejtësinë e të miturve dhe rolin e institucioneve që punojnë me ta dhe për ta. Ndaj, në rast nevoje, i mituri duhet t'i referohet legjislacionit të miratuar dhe që është në fuqi.

Botimi synon të japë disa informacione bazike të miturve në konflikt me ligjin ose të fëmijëve që nuk janë në konflikt me ligjin, për të parandalur sjellje të dënueshme nga Kodi penal. Për ata pak të mitur që mund jenë në konflikt me ligjin, ky botim ofron disa njohuri të përgjithshme për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë fazave të procesit penal.

Termi “i mitur” nënkupton çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, pavarësisht gjinisë

Urojmë që asnjë fëmijë të mos jetë në pozitat e shkeljes së ligjit dhe të këtë nevojë të kërkojë zbatimin e të drejtave dhe rregullave që trajtohen në këtë botim. Nëse një i mitur do të gjendet në konflikt me ligjin për shkaqe që varen ose jo nga ai, shpresojmë që ky informacion t'i vijë në ndihmë për t'u orientuar në lidhje me drejtësinë penale.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e të miturit para ligjit

Çdo fëmijë gëzon të drejtat dhe detyrimet, të cilat parashikohen në ligje dhe akte nënligjore të krijuara nga organe të caktuara dhe që janë të detyrueshme të zbatohen nga çdo i mitur.

Njohja e ligjeve dhe akteve të tjera ka rëndësi pasi çdo fëmijë duhet të ketë informacion për të drejtat që gëzon në jetë dhe në praktikë dhe për përgjegjësitë e detyrimet që ka në raport me veten, me të tjerët dhe shtetin. Sjelljet në familje përcaktohen nga rregullat e bashkëjetesës. Disa të drejta dhe përgjegjësi të anëtarëve të familjes ndaj njëri tjetrit, pra edhe të anëtarëve të familjes ndaj fëmijëve dhe të fëmijëve ndaj pjesëtarëve të familjes janë parashikuar edhe në ligje specifike, si për shembull në Kodin e Familjes.

Disa sjellje të fëmijës në shkollë ose në shoqëri rregullohen me rregulla të parashikuara me rregullore ose me ligje. Për shembull, disa rregulla të sjelljes në shkollë përcaktohen në rregulloren e brendshme të shkollës, disa të tjera si për shembull, ndalimi i tregtimit të pijeve me sheqer të shtuar fëmijës në mjediset e shkollës ose përreth tyre parashikohet në ligj.

2.1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijës përcaktohen në ligje jopenale dhe penale

Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijës përcaktohen në ligje të ndryshme. Për shembull, ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton të drejtat, përgjegjësitë e fëmijës dhe detyrimet që kanë institucionet që fëmijët të gëzojnë realisht të drejtat e tyre.

Disa sjellje, veprime ose mosveprime të cilat sjellin pasoja në shoqëri, ngarkojnë me përgjegjësi fëmijën dhe prindit ose vetëm prindin, nëse fëmija nuk ka arritur moshën e përgjegjësisë që përcaktohet në ligj. Disa veprime janë të dënueshme me ligje jo penale dhe disa të tjera nga ligji penal.

Për shembull, nëse një fëmijë luan me top në mjediset e shkollës ose në mjediset banimi dhe thyen një xham ose shkakton një dëm tjetër, ai ose prindi i tij ka përgjegjësinë për të shpërblyer dëmin e shkaktuar. Disa sjellje brenda familjes janë të dënueshme. Nëse prindi ose një pjesëtar i familjes ose vetë ju ushtroni dhunë psikologjike, fizike ose abuzoni ndaj një pjesëtari tjetër në familje, këto veprime janë vepër penale dhe dënohen nga ligji penal.

Ligj nr. 18/2017 (aksesuar në link: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/02/23/18-2017/a7b5c582-78fa-4109-beca-a0c7b48a2c8c>)



Dallonis sjelljet e dënueshme nga ligji penal dhe jo penal

- Pirja e duhanit në mjedise publike (lokal, bar, restorant shkollë, institucione, në mjetet e transportit publik, etj.) dënohet me gjobë, por nuk është vepër penale.
- Nxitja e një personi për përdorim të lëndëve narkotike ose dhënia e tyre pa dijeni ose pëlqimin e tij është krim dhe dënohet penalisht me burgim. Nëse kryhet në shkollë ose në një mjedis sportiv është krim më i rëndë dhe dënohet me shumë vite burgim.

Veprat e dënueshme penalisht gjenden në Kodin Penal. Të drejtat dhe detyrimet e të miturit që është në konflikt me ligjin ose viktimë gjenden në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. Ky është ligji i parë i miratuar në vitin 2017 që trajton të miturin në konflikt me ligjin duke e trajtuar atë për t'u korrigjuar, rikthyer në shoqëri dhe për t'u mos u përfshirë sërish në kryerjen e ndonjë vepre penale tjetër.

2.2. Ku mund të gjeni informacione për sjelljet e ndaluara dhe të dënueshme nga ligji të tjera jo penale?

Burimet e informacionit janë të larmishme si: në lëndën e njohurive për shoqërinë, ose lëndë të tjera të programeve mësimore, nga prindi, mësuesi/ja, oficeri i sigurisë në shkollë, punonjësit të policisë në komunitet, në faqet zyrtare të internetit të institucioneve, nga media. Mos hezitoni të kërkonti informacion. Gjithashtu, ju mund të pyesni online mes telefonit në numrin jeshil pa pagesë: 0800 10 10 ose të shkruani te “Juristi online” në adresën: <https://juristionline.al/>

Disa sjellje të dënueshme penalisht dhe që duhet të parandalohen:

- Drejtimi i automjetit ose mjeteve të tjera të motorizuara pa leje drejtimi ose në gjendje të dehur ose nën efektin e lëndëve narkotike;
- Hakërimi i adresës personale në internet ose rrjetet sociale (marrja dhe përdorimi i pasëordit pa lejen e personit)



- Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anë të veprimeve që shkakton ankth ose frikë për të ose detyron të ndryshojë sjellje (për shembull, dërgimi i mesazheve ngacmuese e shqetësuese në telefon, ndjekja në rrugë ose mjedise të tjera);
- Shantazhimi me foto ose video për të kërkuar një përfitim pasuror ose jo pasuror, (për shembull detyrimi të kryejë një veprim pa dëshirën e tij/ saj ose të heshtë për diçka që ka ndodhur);
- Shpërndarja e drogës dhe substancave të tjera narkotike ose nxitja për përdorimin e drogës;
- Reklamimi i materialeve pornografike ose krijimi i aksesit me qëllim, në materiale pornografike me fëmijë;
- Vjedhja (marrja pa leje e një sendi personit dhe qëllim për të mos e kthyer më);
- Shkatërimi ose dëmtimi i pronës;
- Rrahja dhe çdo vepër tjetër dhunë;
- Plagosja e kryer me dashje ose pakujdesi;
- Marrëdhëniet seksuale pa dëshirën e personit tjetër ose me fëmijë që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale;
- Ngacmimet seksuale ose kryerja e veprave të turpshme;
- Fallsifikimi i një dokumenti (raport mjekësor, dëftesë, leje drejtimi mjete);



Disa prej rasteve të kundërvajtjeve penale janë:

- Ndërhyrja e padrejtë në jetën private të një personi (regjistrimi i fjalëve, figurave video, ruajtja për publik ose publikimi i tyre, pa pëlqimin e personit);
- Njoftimi i rremë që i bëhet policisë për një vepër penale ose për ta vënë atë në gjendje alarmi;
- Prishja e qetësisë publike duke hedhur gurë ose sende në një banesë, krijimi i zhurmave, plasjet e kapsollave, përdorimi i sirenavë të automjeteve dhe sjelljet e papëlqyera në mjedise publike, sheshe, etj.
- Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (për shembull, telefonon me numër anonim duke e bezdisur një person);
- Vetgjyqësia, pra ushtron të drejtën tënde, pa ju drejtuar një organi që ka përgjegjësi për të zgjidhur problemin;
- Largimi nga vendi i aksidentit i drejtuesit të automjetit ose çdo mjeti tjetër të motorizuar;
- Hedhja ose braktisja e shiringave në vende publike ose të hapura për publikun dhe mjedise të përbashkëta ose të mjeteve të tjera të përdorura për marrjen e substancave narkotike;
- Fyerja në internet që i bëhet një personi për shkak të besimit fetar, kombësisë, etnisë së tij etj;
- Shpifja, përhapja me qëllim e thënieve ose informacioneve të rreme që çënojnë dinjitetin dhe nderin e personit;
- Kalimi i kufirit, jo në vendet e përcaktuara me ligj;
- Kur nga braktisja e kafshës së shoqërimit ose nga mosvendosja e maskës mbrojtëse ndaj kafshës së shoqërimit, në ambiente publike ose në mjedise të hapura për publikun, kanë ardhur pasoja në dëm të shëndetit të një personi;

- Keqtrajtimi ose torturimi i një kafshe, duke i shkaktuar dëmtime të përhershme shëndetësore është kundërvajtje, por nëse kafsha është plagosur rëndë ose ka vdekur, vepra është krim;

Kujdes:

ligji i dënon fëmijët kur kryejnë një vepër penale të shtyrë ose të nxitur nga një person i rritur qoftë prind, i afërm, i njohur ose person i panjohur. Në këtë rast dënohet edhe personi i rritur që nxit fëmijën.

Përshembull,

Nëse ju pranoni lëndë narkotike (drogë) nga një i rritur ose shoku juaj për ta mbajtur ose transportuar, dhe keni dijeni për të, ky veprim është krim;

Fshehja ose pranimi i sendeve të vjedhura dënohet penalisht. Nëse gjatë shoqërisë me persona të tjerë, moshatarë ose të rritur, njëri prej tyre kryen një krim dhe ju e ndihmoni atë të fshehtë gjurmët e krimit (për shembull thikën, një shufër hekuri), ose nuk e kallëzoni atë, ju keni përgjegjësi penale dhe dënoheni për moskallëzim të krimit, ose përkrahje e autorit të krimit, ose për veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës

3. Në cilën moshë ligji ngarkon me përgjegjësi penale të miturin?

Kodi parashikon dy mosha të ndryshme për përgjegjësinë penale: moshën 14 vjeç kur i mituri kryen një vepër penale që ligji e ka përcaktuar krim dhe 16 vjeç kur kryen një kundërvajtje penale, pra një vepër penale që është më pak e rrezikshme.

Kjo nuk do të thotë se i mituri nën moshën 14 vjeç që kryen një vepër penale nuk ka përgjegjësi. I mituri nuk ka përgjegjësi penale, por mban përgjegjësi për veprimet që kryen. Gjykata mund të caktojë masa edukative ndaj të miturit. Për shembull, i mituri mund të vendoset nën mbikqyrje ose t'i nënshtrohet programeve të trajtimit të



hartuara nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve që funksionojnë pranëbashkive si: të qëndrojnë në familje ose te një i afërm, ose mbikqyret për të shkuar në shkollë rregullisht, për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme ose i kërkohet të ndjekë një trajtim mjekësor ose këshillim psikologjik; ose i ndalohej të shkojë ose të frekuentojë vende të caktuara. Prindërit mbajnë përgjegjësi për veprimet e fëmijës së tyre dhe ngarkohen për të riparuar ose kompesuar dëmin e shkaktuar. Kur fëmija mbush moshën 18 vjeç, ligji e trajton atë si person të rritur.

4. Zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

Sikurse është thënë më lart, Kodi zbatohet ndaj të miturve që janë në konflikt me ligjin, për fëmijën viktimë të veprës penale që kryhet nga të tjerët, përfshirë prindin ose kujdestarin ose person të panjohur dhe për fëmijët dëshmitarë të një veprë penale.

Kodi Penal mbron fëmijët nga abuzimet e ndryshme, përfshirë ato që kryhen nëpërmjet internetit dhe pornografia online; keqtrajtimi fizik, psikologjik, shpirtëror; detyrimi, shfrytëzimi për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur ose për të kryer veprime të tjera që dëmtojnë zhvillimin mendor të fëmijës; kur prindi ose kujdestari nuk jep mjetet e jetesës fëmijës ose e braktis atë.

4.1. Drejtësia miqësore për çdo fëmijë

Drejtësia miqësore për çdo fëmijë do të thotë një drejtësi që respekton dhe zbaton të gjitha të drejtat e fëmijës; një sistem që ka mundësi t'i drejtohet çdo fëmijë në çdo kohë dhe që ofron shërbime në pëpëthje me moshën e fëmijës, shpejt dhe e përshtatuar sipas nevojave të saj; fëmija merr pjesë dhe dëgjohet në një proces të rregullt dhe ku respektohet jeta private e familjare, integriteti dhe dinjiteti i fëmijës.



4.2. Ç'ndodh pas kryerjes së një veprë penale?

Policia ka të drejtë të shoqërojë të miturin në komisariat kur dyshohet se ka kryer një veprë penale ose kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së saj. Nëse vepra penale ka rrezikshmëri të vogël, policia pasi e pyet të miturin mund ta lërë të lirë të shkojë në shtëpi, por procesi ndaj tij mund të vijojë.

Për shembull, nëse disa nxënës grinden dhe rrihen në rrugë, punonjësi i policisë mund t'i shoqërojë në komisariat, t'i këshillojë dhe të kërkojë ndërmjetësimin mes tyre. Nëse një i mitur kapet duke shpërndarë lëndë narkotike ose duke kryer një vjedhje punonjësi i policisë e shoqëron atë në komisariat dhe nëse nuk urdhërohet lirimi i të miturit, brenda 48 orëve nga ndalimi ose arrestimi, i mituri dërgohet para gjykatës që vlerëson masën dhe vendos nëse i mituri do të qëndrojë në paraburgim ose do të lihet i lirë. Lënia e lirë nuk do të thotë se hetimi ndaj të miturit nuk do të vijojë. Nëse i mituri nuk del para gjykatës brenda 48 orëve, ai lirohet menjëherë.

Ka raste kur i mituri mund të dyshohet në mënyrë të arsyeshme nga policia se ka kryer një veprë penale, ose punonjësi i policisë shoqëron të miturin për efekt mbikëqyrje për qëllime edukimi. Mund të ketë edhe raste kur një grup të miturish që nuk kanë karta identiteti ose një dokument tjetër identifikimi dyshohet se kanë kryer një veprë penale pranë një lagjeje, të ndryshme nga lagjia e tyre. Në të gjitha këto raste, policia ka të drejtën të shoqërojë të miturin deri në 10 orë në ambientet e komisariatit.

5.Çfarë ndodh nëse një i mitur arrestohet?

I mituri informohet menjëherë për të njoftuar prindin. I mituri jep të dhënat sesi do të njoftohet prindi. Në mungesë të prindit, njoftohet një person tjetër i rritur, i kërkuar dhe i pranuar nga i mituri. Prindi ose përfaqësuesi ligjor njoftohet se ku gjendet i mituri, si dhe arsyet e arrestimit të tij.

I mituri informohet për arsyet e arrestimit dhe të drejtat e tij me gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme. I mituri pajiset edhe me “Letrën e të drejtave”, një dokument ku janë shkruar me një gjuhë të kuptueshme të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin. Punonjësi i policisë informon të miturin për të drejtën e mbrojtjes nga ana e avokatit falas nga shteti, ose avokat të zgjedhur nga familja. Gjithashtu, çdo procedurë ligjore me të miturin realizohet në prani të psikologut.



Prania e mbrojtësit (avokatit) dhe psikologut janë të detyrueshme në të gjitha veprimet me të miturin. Psikologu ndihmon në përmbajtjen e pyetjeve, lehtëson dhënien e dëshmisë, krijon një mjedis të qetë për të miturin. Mbrojtësi përfaqëson të miturin dhe e ndihmon në të gjitha veprimet dhe fazat e procedimit. I mituri duhet të qëndrojë në një mjedis miqësor, veçmas nga të rriturit.

Nëse je i mitur në konflikt me ligjin duhet të dinisë:

- Ndalohet çdo lloj keqtrajtimi fizik dhe/ose psikologjik gjatë marrjes në pyetje ose me qëllim marrjen e ndonjë lloji informacioni prej jush;
- Ndalohet marrja në pyetje gjatë natës, nga ora 22⁰⁰ – 8⁰⁰;
- Nëse prindi ose kujdestari nuk gjendet ose nuk është i disponueshëm, ose ai ka abuzuar me ju (për shembull në rastin e një krimi në familje) ose ka dyshime për paanshmërinë e tij, njoftohet menjëherë Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës që ju përfaqëson. Ju keni të drejtë të shprehni mendimin tuaj për personin që do t'ju përfaqësojë.
- Ju mund të zgjidhni të mos flisni, përveç të dhënave për emrin, mbiemrin dhe vendin ku banoni;
- Nëse pranoni fajin që keni bërë, duhet ta thoni lirshëm dhe jo nën presion ose në këmbim të një premtimi.
- Kur hyni në komisarariat ose në institucionin e paraburgimit, ju do t'i nënshtroheni kontrollit personal. Ju keni të drejtë të informoheni për arsyet e kontrollit;

Kontrolli kryhet nga persona të së njëjtës gjini;

- Kontrolli intim dhe mjekësor kruhet vetëm me vendim gjykatë, përveç rasteve kur jeta e të miturit është në rrezik ose ka rrezik që informacioni ose prova mund të humbasë ose shkatërrohet.



Kodi parashikon se arresti në burg për të miturin duhet të jetë masa e fundit. Arresti në burg vendoset kur i mituri akuzohet për kryerjen e veprës penale për të cilin ligji parashikon dënimin me burgim në minimum mbi 7 vjet; ose vlerësohet se lënia e lirë e tij përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër ose nëse ka dyshime që ju përpiqenit t'ishmangeni drejtësisë.

Gjykata mund të vendosë ta lirojë të miturin dhe ta vendosë nën mbikëqyrjen e prindit ose të një të afërmi ose në një shërbim të specializuar dhe të miturit i kërkohet të përmbushë disa detyrime. Para se të merret vendimi, kërkohet pëlqimi i të miturit. Në rast se i mituri nuk përmbush detyrimet e veçanta, ai vendoset në një qendër/institucion disiplinor/edukues për qëndrim të pandërprerë, për jo më shumë se një muaj. Nëse gjykata vendos që i mituri duhet të qëndrojë i arrestuar, i mituri vendoset në një institucion për të miturit dhe veçmas nga të rriturit.

6. Zbatimi i masave alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimi

Për herë të parë Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon shmangien nga ndjekja penale dhe dënimi i të miturit. Kjo masë synon të ndihmojë të miturin që të vijojë shkollën ose kurset e formimit profesional, të përfshihet në programe edukimi dhe rehabilitimi, të rikthehet në familje dhe shoqëri për të vijuar një jetë të sigurt dhe të shëndetshme. Ligjbërësi e parashikoi një masë të tillë pasi burgimi ka pasoja të rënda në zhvillimin fizik, psikologjik dhe emocional të të miturit, megjithë përmirësimet e kushteve në burgje. Burgosja e të miturit, lë gjurmë në jetën e tij. Liria e të miturit kufizohet, dhe të miturit i mbeten shënime në gjendjen gjyqësore si person i dënuar.

Shmangia nga ndjekja penale mund të kërkohet nga i mituri ose përfaqësuesi i tij ose mund të propozohet nga prokurori ose gjykata, por i mituri duhet të japë pëlqimin. Megjithatë, shmangia është e mundur vetëm për një grup veprash penale. Konkretisht, kur vepra penale për të cilën akuzohet i mituri dënohet me gjobë ose burgim deri në 5 vjet në maksimum dhe nëse i mituri e pranon kryerjen e veprës penale dhe shpjegon lirshëm atë që ka kryer; i mituri nuk duhet të ketë kryer më parë ndonjë vepër penale, nuk duhet të jetë përsëritës ose të ketë marrë pjesë në një program ku është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose ndërmjetësimi.

Nëse je i mitur në konflikt me ligjin duhet të dini se:

Parasë të jepni pëlqimin për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale keni të drejtë të informoheni në mënyrë të detajuar për masën, kohëzgjatjen e saj, kushtet dhe mënyrën e zbatimit, pasojat në rast se dërimet nuk përmbushen;

- Pëlqimi për zbatimin e shmangies duhet të jepet me shkrim;
- Gjatë negociimit të marrëveshjes, ju duhet të konsultoheni me mbrojtësin tuaj;
- Në rast pranimi, marrëveshje përcakton llojin e masës së shmangies dhe/ ose ndërmjetësimin;
- Marrëveshje firmoset nga ju dhe prokurori;
- Në rast zbatimi të masës së shmangies, njoftohet viktimja pasi ajo ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin.

7. Cilat janë masat që mund të jepen ndaj të miturit kur vendoset shmangia?

Ligji parashikon disa masa të shmangies nga ndjekja penale si: pjesëmarrja e të miturit në programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit; këshillimi i të miturit dhe familjes së tij nëpërmjet paralajmërimit me gojë/verbal; paralajmërimit me shkrim; caktimi i masave detyruese; vendosja e të miturit nën kujdes. Zbatimi i masës së shmangies është në dobi të të miturit. Nëse vendoset kjo masë, procedimi penal nuk fillon, ose nëse nëse ka filluar ai pushon. I mituri duhet të përmbushë detyrimin dhe kur ndodh kjo, ai nuk konsiderohet i dënuar për një veprë penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale. Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit me kusht që i mituri në konflikt me ligjin të përmbushë disa detyrime:

- të riparojë ose kompesojë dëmin e shkaktuar;
 - të përfshihet në programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
 - të punojë në organizata humanitare ose të kryejë punë në dobi të komunitetit;
 - i mituri/a që është në varësi të drogës ose ka varësi të tjera, pranon t'i nënshtrohet trajtimit për t'u shëruar nga varësia.
- Në rast se dërimet e vendosura përmbushen, procedimi penal ndaj të miturit pushon.

7.1. Drejtësia restauruese

Programet e drejtësisë restauruese janë programe miqësore për të miturit që kanë për qëllim që i mituri të korrigjojë pasojat që ka shkaktuar vepra penale ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë. Kur zbatohet një program i tillë, i mituri nuk procedohet, hetohet, gjykohet dhe dënohet.

- Këto programe zbatohen jashtë sistemit gjyqësor dhe i mituri mund të marrë pjesë në to nëse jep pëlqimin e tij. Gjatë pjesëmarrjes në program mund të kërkohet për shembull që i mituri të pranojë dhe të tregojë se e ka kuptuar përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës; të kompensojë dëmin e shkaktuar; t'i kërkojë falje viktimës. I mituri mund të përfshihet në ndërmjetësim, të kryejë një punë me interes publik ose programe që rehabilitojnë pasojat e shkaktuara.

- Nëse je i mitur në konflikt me ligjin për shkak se keni marrë mjetin e babait, ndonëse nuk keni leje drejtimi dhe gjatë përdorimit keni dëmtuar një mjet tjetër të parkuar

Sikurse është thënë më lart, drejtimi i automjetit pa leje drejtimi është krim dhe dënohet nga Kodi Penal. Në rast të tillë:

- Ju mund t'i kërkonit falje personit që i keni dëmtuar makinën;
- Paguani dëmin e shkaktuar;
- Në rast se marrëdhëniet me personi e dëmtuar nuk janë normalizuar, mund të kërkonit ndihmë për të ndërmjetësuar me të.

7.2. Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi është një masë shmangie që ka për qëllim të zgjidhë një mosmarrëveshje mes të miturit në konflikt me ligjin dhe personit të dëmtuar. Ndërmjetësimi zbatohet nëse është i përshtatshëm për natyrën e veprës penale (për shembull, rrahje, fyerje, dëmtim prone etj) rrethanat në të cilat është kryer ajo; mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe personit të dëmtuar, zvogëlimin e dëmit dhe mundësinë e rehabilitimit dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri. Ndërmjetësimi zhvillohet jashtë prokurorisë dhe gjykatës nga një person i pavaruar që quhet ndërmjetës.



Mbani mend:

Nëse jeni përfshirë në një konflikt, ose i keni shkaktuar një dëm shokut/shoqes në shkollë, përpiquni ta zgjidhni konfliktin me ndërmjetësim.

- Ndërmjetësimi është një mundësi e mirë për përmirësimin e marrëdhënieve me personin e dëmtuar nga vepra penale;
- Ndërmjetësimi kërkon që si ju dhe viktimat të jepni pëlqimin dhe të merrni pjesë në procesin e ndërmjetësimit;
- Ndërmjetësimi ju mundëson kërkimin e faljes, përmirëson, normalizon marrëdhëniet mes jush dhe personit të dëmtuar, zvogëlon dëmin e shkaktuar dhe ju vijoni jetën normale në shoqëri;

Ju mund t'i drejtoheni oficerit të sigurisë në shkollë, nëse ka një të tillë, mësueses kujdestare ose një mësuesi me të cilin ndiheni mirë dhe të kërkonit t'ju ndihmojë për të mundësuar ndërmjetësimin me personin e dëmtuar. Gjithashtu, prindërit tuaj dhe të shokut ose shoqes së dëmtuar mund të marrin pjesë në këtë proces.

8. Masat detyruese ndaj të miturit në rast të shmangies

Kodi parashikon mundësinë e caktimit ndaj të miturit të një ose më shumë prej masave detyruese, si ndalimi:

- të kontaktojë/takojë një person të caktuar;
- të shkojë/vizitojë një vend të caktuar;
- të ndryshojë vendin e banimit;
- të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar;
- të largohet paleje nga një vend i caktuar;
- të kryejë ndonjë veprim tjetër që pengon rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij.

9. Çfarë ndodh nëse masa e shmangies ose detyrimet e caktuara nuk përmbushen nga i mituri?

Në rast se i mituri heq dorë nga marrëveshja për zbatimin e shmangies, procedimi penal fillon ose nëse ishte pezulluar, ai rifillon. Në rast se i mituri nuk ka hequr dorë nga marrëveshja, por nuk përmbush detyrimet e caktuara, masa e shmangies anulohet pjesërisht ose plotësisht, ose ndryshon lloji i masës së dhënë ose zgjatet koha e marrëveshjes. Gjithashtu, Kodi parashikon vendosjen e të miturit në një qendër ose institucion edukimi për të qëndruar, në rastet kur i mituri nuk përmbush detyrimet. Në rast se vendoset rifillimi i procedimit ose hetimit, i mituri do të hetohet, gjykohet dhe mund të dënohet. Pjesa e detyrimeve që janë përmbushur nga i mituri mbahen parasyh gjatë hetimit dhe gjyqimit të tij.

9.1. Vendosja nën kujdes të miturit

I mituri në konflikt me ligjin mund të vendoset nën kujdesin e një personi ose shërbimit të specializuar, në rast se kujdesi i prindit ose kujdestarit nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur qëllimin e masave detyruese dhe riintegrimin e të miturit. I mituri vendoset pranë shërbimit të specializuar përgjatë 24 orëve ose me kohëzgjatje të pjesshme. I mituri vijon shkollën, punën dhe përfshirjen në aktivitete të dobishme. I mituri ndihmohet për të pëmirësuar për t'u integruar në shoqëri nga profesionistë të ndryshëm, sipas nevojave që ka.



9.2. Hetimi, të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin

I mituri që është në konflikt me ligjin ka disa të drejta si:
e drejta për të heshtur dhe për të mos dhënë dëshmi;

- e drejta për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar;
- e drejta për mbrojtje juridike falas;
- e drejta për ndihmë nga psikolog falas;
- e drejta për t'u informuar për akuzën dhe ecurinë e procesit;
- e drejta për ankim në çdo fazë të procesit penal ose nëse është i dënuar, gjatë ekzekutimit të vendimit penal;
- e drejta për privatësi dhe garantim të jetës personale. Ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdolloj forme i të dhënave personale të të miturit;
- të ketë prindin ose kujdestarin ligjor të pranishëm në pyetje, nëse nuk dëmton interesin e tij;
- të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë.

Duhet të dinise:

- Prania e avokatit dhe psikologut është e detyrueshme në çdo fazë. Psikologu mbështet psikologjikisht dhe vlerëson thëniet e të miturit;
- I mituri me aftësi të kufizuar në dëgjim, shikim, në të folur, informohet dhe asistohet nga interpreti i shenjave. Në rast se i mituri nuk kupton gjuhën shqipe, ka të drejtë të ketë përkthyes;
- Shërbimet për të miturit janë falas.



10. Gjykimi

Qëllimi i ligjit është që i mituri të mbahet larg nga procesi penal. Por, për shkak të veprës penale të kryer, sjelljes së të miturit ose përvojës kriminale të mëparshme të tij, i mituri shkon në gjykatë.

Pjesëmarrja e të miturit në gjykim është e detyrueshme. Prandaj, mjediset duhet të jenë miqësore për të. Seancat në gjykatë bëhen me dyer të mbyllura dhe sa më shpejt. I mituri ndihmohet nga mbrojtësi dhe psikologu. Ata e këshillojnë në çdo kohë, kur do të flasë dhe çfarë do të thotë. Sjella e të miturit në seancë ka rëndësi dhe ndikon në vendimin që do të merret për të. Gjykata mund të largojë të miturin nga seanca kur do të shqyrtojë ndonjë provë dhe kjo është në interesin më të lartë të të miturit.

Nëse je i mitur në konflikt me ligjin:

- Nuk mund të detyrohesh të bësh deklarime;
- Ke të drejtë të heshtësh;
- Pranimi i fajësisë bëhet vetëm nëse e keni kryer veprën; Nëse jeni të lodhur nga zgjatja e seancës, ke të drejtë të kërkohsh pushim.

11. Dënimi i të miturit

Gjykata mund ta dënojë të miturin për veprën penale të kryer. Dënimi me burgim është dënimi më i rëndë që mund të jepet kur i mituri ka kryer një veprë penale për të cilën ligji parashikon 7 vjet burg si dënim në minimum. Gjykata vlerëson se dënimi është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së veprës penale së kryer nga i mituri dhe shkallës së fajësisë.

Dënime të tjera që mund të zbatohen ndaj të miturit janë: kufizimi i lirisë, gjoba, kryerja e një pune me interes publik, ndalimi për të kryer një veprimtari ose i mituri detyrohet të përmbushë disa detyrime si për shembull të ndjekë arsimin e detyrueshëm, programin profesional, të riparojë dëmin etj.

Gjykata mund të caktojë edhe një ose disa dënime plotësuese ndaj të miturit. Për shembull, i mituri detyrohet të kryejë një punë me interes publik, të qëndrojë në shtëpi, të ndjekë një program rehabilitues në varësi të nevojave psikologjike, mjekësore, program detoksikues nga alkooli ose droga.

Gjykata mund të vendosë pezullimin e dënimit me burgim kur ajo ka dhënë dënim deri në pesë vjet, i mituri nuk është i dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale. Në këtë rast, i mituri nuk mbahet në burg, por vendoset nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës.

13. Çfarë ndodh pas lirimit me kusht ose përfundimit të dënimit?

Ligjbërësi është kujdesur që i mituri të mbështetet në procesin e riintegritimit në familje, shkollë dhe shoqëri pas lirimit me kusht ose kryerja e dënimit. Për këtë hartohet plani i ri-integritimit i cili përmban të gjitha shërbimet që i mituri ka nevojë për të paktën deri në 6 muaj pas lirimit.

Nëse je i mitur në konflikt me ligjin:

Pas lirimit, ju mund të riktheheni në familje ose pranë kujdestarit tuaj. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës pranë bashkisë ju asiston për nevojat që keni. Nëse keni nevojë dhe familja nuk ju mbështet, ju mbështeteni me:

- veshje të përshtatshme;
- mbështetje psikologjike;
- shpenzimet e udhëtimit për në banesë;
- mundësimin e ndjekjes së kurseve të formimit profesional.
- strehimin e përshtatshëm nëse nuk keni.

14.1 Institucionet përgjegjëse që trajtojnë të miturin në konflikt me ligjin

I mituri në konflikt me ligjin bashkëpunon me disa institucione dhe profesionistë që kanë për detyrë ta mbështesin dhe ta ndihmojnë atë në situatën ku gjendet.

- Oficeri i sigurisë në shkollë, nëse ka një tillë në shkollë ku i mituri studion;
- Punonjësi social/psikologu në shkollë;
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ndjek të miturin në bashki ose njësinë administrative;
- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve;
- Shërbimi i provës;
- Avokati i Popullit, nëpërmjet Seksionit të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.



Në rast se gjatë kësaj kohe i mituri kryen një veprë tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë vendimin. Dënimi jo me burgim mund të kthehet në dënim me burgim. I mituri kryen dënimin në një institucion të posaçëm për të miturit. I mituri mund të lirohet me kusht nga vendi ku kryen dënimin kur ka kryer një pjesë të dënimit. Pjesa që duhet të kryejë përcaktohet në Kod. Në rast se i mituri, lirohet me kusht dhe gjatë kohës shkel kushtet, gjykata ka të drejtë të revokojë vendimin e dhënë.

Nëse je i mitur në konflikt me ligjin:

Gjykata mund të caktojë një dënim më të ulët se ai që parashikon kodi për veprën penale të kryer ose një dënim më të butë. Kjo është e mundur kur gjykata vlerëson se:

- vepra penale e kryer dhe ju keni rrezikshmëri të pakët;
- nuk jeni dënuar më parë;
- ka disa rrethana lehtësuese të kryerjes së veprës;
- nuk ka asnjë rrethanë rënduese.

12. Çfarë ndodh para mbarimit të dënimit dhe daljes nga institucioni?

Para kryerjes së plotë të dënimit ose lirimit me kusht, para se i mituri të rikthehet në familje dhe/ose shoqëri, ai nuk është i vetëm. Përgatitja për rikthimin e të miturit fillon që në momentin kur i mituri hyn në institucion. Për të përgatitur të miturin për lirim hartohet plani individual për riintegrimin e të miturit. I mituri bashkëpunon për hartimin e tij. Të paktën tre muaj para datës së mbarimit të dënimit ose lirimit me kusht, i mituri ka të drejtë:

- të informohet për datën e mbarimit të dënimit;
- të marrë mbështetje psikologjike dhe arsimore për t'u përgatitur për lirim;
- të bëjë vizita të shkurtra në shtëpi;
- të marrë informacion në mënyrë të kuptueshme për mbështetjen dhe ndihmën që mund të përfitoni pas kryerjes së dënimit;

Nëse je i mitur në konflikt me ligjin:

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve është krijuar me qëllim mbikëqyrjen dhe mbrojtjen tuaj pas kryerjes së dënimit për veprën penale të kryer. Një përfaqësues i Qendrës në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës do t'ju kontaktojë në një mjedis të përshtatshëm dhe do të diskutoni për kushtet dhe kërkesat e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit tuaj. Një vlerësim të situatës sociale dhe nevojave e kanë përgatitur edhe administrata e institucionit. Diskutoni me profesionistët që ju kanë kontaktuar për nevojat që keni.

- o Vetëm nëse i mituri jep pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;
- o I mituri është sqaruar me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për përparësitë e masës së shmangies, detyrimet dhe pasojat e mospërbushjes së detyrimit..

4. Ndërmjetësimi mes të miturit në konflikt e ligjin dhe viktimës ka për qëllim:

- o Të zgjidhë një mosmarrëveshje mes të miturit dhe viktimës;
- o Të përmbushë kërkesën e të miturit, pavarësisht se nuk pranohet nga viktimë;
- o Normalizon marrëdhëniet me të miturit dhe viktimës (palës së dëmtuar);
- o Të zvogëlojë dëmin e palës së dëmtuar.

5. Gjatë zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese të miturit mund t'i kërkohe:

- o Të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
- o T'i kërkojë falje viktimës;
- o Të kryejë një punë në interes publik;
- o I mituri nuk ka asnjë detyrim, përveçse të shkojë në shkollë.

6. Para mbarimit të dënimit dhe rikthimit në familje, i mituri ka të drejtë:

- o Të informohet për datën e mbarimit të dënimit;
- o Të mbështetet psikologjikisht për lirim;
- o T'i jepet një informacion me shkrim për mbështetjen dhe ndihmën që mund të përfitojë pas kryerjes së dënimit;
- o Institucioni nuk ka asnjë detyrim para lirimit ose kryerjes së dënimit.

Fëmija bashkëpunon me prindërit, ose përfaqësuesin ligjor ose familjen kujdestare, shkollën, institucionet që ofrojnë formim profesional ose punësim në përputhje me mshën dhe në punë të kejuar për të miturit, me komunitetet fetare, organizata të shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje dhe shërbime për fëmijët.

Punonjësi i policisë, gjyqtari dhe prokurori ose punonjësi ku vendoset i mituri në konflikt me ligjin në çdo veprim dhe vendim kujdestar për të miturin dhe veprojnë me qëllimin e rikthimit të tij në shoqëri dhe vijueshmërinë e jetës së sigurt.

Provo veten

Gjej përgjigjen e saktë:

1. ***Në rastet e ndalimit ose arrestimit të të miturit nga policia:***

- o Njoftimi i prindit të të miturit është në dëshirën e punonjësit të policisë;
- o Prania e avokatit është e detyrueshme;
- o Për pak orë i mituri mund të qëndrojë në një mjedis me persona të rritur
- o Prania e psikologut është e detyrueshme;
- o Ndalohej çdo lloj keqtrajtimi fizik dhe/ose psikologjik gjatë pyetjes ose me qëllim marrjen e ndonjë lloj informacioni prej jush;

2. ***Nëse një i mitur ka kryer një vepër penale, ai ka disa të drejta si:***

- o E drejta për t'u dëgjuar;
- o E drejta për mbrojtje juridike, por duhet ta paguajë atë;
- o Identifikimi ose publikimi i të dhënave personale të të miturit mund të bëhet pa kufizim;
- o E drejta për t'u informuar për akuzën dhe ecurinë e procesit;
- o Prindi ose kujdestari ligjor duhet të jenë të pranishëm në pyetjen e të miturit gjithnjë;
- o Në raste të veçanta i mituri detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë;
- o E drejta për të marrë pjesë në proces dhe për t'u dëgjuar.

3. ***Shmangia nga nga ndjekja penale mund të vendoset:***

- o Për çdo vepër penale;
- o Vetëm ndaj të miturit që nuk ka kryer ndonjë vepër penale më parë;
- o Ndaj të miturit i cili nuk ka marrë pjesë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;



4. Ndërmjetësimi mes të miturit në konflikt e ligjin dhe viktimës ka për qëllim:

- o Të zgjidhë një mosmarrëveshje mes të miturit dhe viktimës;
- o Të përmbushë kërkesën e të miturit, pavarësisht se nuk pranohet nga viktimë;
- o Normalizon marrëdhëniet me të miturit dhe viktimës (palës së dëmtuar);
- o Të zvogëlojë dëmin e palës së dëmtuar.

5. Gjatë zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese të miturit mund t'i kërkohej:

- o Të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
- o T'i kërkojë falje viktimës;
- o Të kryejë një punë në interes publik;
- o I mituri nuk ka asnjë detyrim, përveçse të shkojë në shkollë.

6. Para mbarimit të dënimit dhe rikthimit në familje, i mituri ka të drejtë:

- o Të informohet për datën e mbarimit të dënimit;
- o Të mbështetet psikologjikisht për lirimin;
- o T'i jepet një informacion me shkrim për mbështetjen dhe ndihmën që mund të përfitojë pas kryerjes së dënimit;
- o Institucioni nuk ka asnjë detyrim para lirimit ose kryerjes së dënimit.



7. Pas liritimit nga institucioni ose përfundimi i dënimit:

- o Një përfaqësues i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve kontakton të miturin;
- o Hartohet plani individual i rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit;
- o Çdo i mitur mbështetet me veshje të përshtatshme;
- o Çdo të mituri i ofrohet strehim i përshtatshëm;
- o I mituri asistohet për ndjekjen e kurseve të formimit profesional;
- o Programi i rehabilitimit është i detyrueshëm për çdo fëmijë pas liritimit të tij.

8. Rendisni përparësitë e zbatimit të masave të shmagies së të miturit nga ndjekja penale ose dënimi.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

9. Rendisni përparësitë e zbatimit të programit të mbështetjes /ose mbikqyrjes së të miturit pas liritimit.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....